

KONTRATA SOCIALE DURRËS

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2020-SHTATOR 2021

Viti i II-të i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
QENDRA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE

RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

TË KONTRATËS SOCIALE

BASHKIA DURRËS

POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
Shtator 2020– Shtator 2021

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë;

Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;

Qendra Rinore Vlorës,

Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;

Epoka e Re, Fier;

Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;

Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;

Qendra Rinore për Progres, Kukës,

Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec

“Hapa të Lehtë”, Vau i Dejës; “

"Tjetër Vizion", Elbasan;

"Gruaja në Zhvillim", Korçë.

Ky Raport është Përgatitur nga Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në kuadër të projektit POP 2019 “Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi e vetëm autorëve.

Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIME	5
FALENDERIME	6
HYRJE	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	8
METODOLOGJIA.....	9
KONTRATA SOCIALE E BASHKISË DURRËS	10
PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE	11
PRIORITET 1:.....	11
PRIORITET 2	13
PRIORITET 3.....	13
PRIORITET 4.....	13
PRIORITET 5.....	13
PRIORITET 6:.....	15
PRIORITET 7:.....	16
PRIORITET 8.....	16
PRIORITET 9:.....	17
PRIORITET 10:.....	17
REKOMANDIME PËR BASHKINË DURRËS.....	18
ANEKSE	20

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID 19	Pandemia e Virusit Korona
Kontrata Sociale ¹	13 prioritetet kryesore të identifikuara komuniteti gjatë 2019

¹ <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-durres/>

Falenderime!

Me mirënjohje falenderojmë të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij raporti për të vlerësuar qeverisjen vendore Në përmbushjen e prioritetëve të kontratës sociale të nënshkruar në Qershor 2019 në Bashkinë Durrës.

Falenderojmë Bashkinë Durrës, sidomos Drejtorinë e Shërbimit Social, për përgjigjen e shpejtë brenda afatit kohor, si edhe Këshillin Bashkiak Durrës, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë periudhës Shtator 2020-Shtator 2021.

Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP), të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve, ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin disa Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Për të hartuar "Kontratën Sociale të Bashkisë Durrës", CSDC Durrës ka zhvilluar në muajin mars 2019, 6 Forume me banorë të lagjeve të qytetit Durrësit, Katundit të Ri, Manzës, Rrashbullit dhe Sukthit. Forumet kishin si qëllim diskutimin e çështjeve me interes për komunitetet lokale, si dhe identifikimin e prioritetëve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej 6 Forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me niveleve të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Nga forumet dolën gjerësisht 26 çështje prioritare të cilat më pas u sintetizuan në një dokument edhe më specifik atë të prioritetëve të shkurtuara të firmosur nga dy kandidatet për kryetare bashkie znj. Valbona Sako, për Partinë Socialiste dhe znj. Valbona Sakollari, kandidate për partinë Bindja Demokratike në 23 Qershor 2019.

Gjatë vitit 2021 projekti vijon me "Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal." Gjatë kësaj faze të kësaj nisme POP synon që të llobojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratën Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, Vau i Dejës, Elbasan, Korçë gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioritetëve të kontratës sociale për periudhën Shtator 2020 – Shtator 2021.

Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të Qeverisjes vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendore si dhe monitorim të mbledhjeve të Këshillit Bashkia dhe të zbatimit të prioritetëve të kontratës sociale.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CSDC) Durrës, për një periudhë të rëndësishme të vitit 2021, ka përshtatur aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Gjatë muajve Shtator 2020 - Shtator 2021 organizata kishte si qëllim:

- Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- Të monitorojë Këshillin Bashkia dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioritetëve të Kontratës Sociale;
- Realizimi i fokus grupeve me qytetarët në lidhje me përmbushjen e prioritetëve të përcaktuara në Kontratën Sociale;
- Monitorim i mediave lokale
-

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Përmbledhje Ekzekutive

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe të përçojë te qytetarët informacionin në lidhje me vendimmarrjen lokale si të orientojë politikbërjen dhe vendimmarrjen lokale drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre.

Informacioni i përfshirë në këtë raport prezanton ecurinë e POP për Qeverisjen në Bashkinë Durrës në periudhën shtator 2020 - shtator 2021 dhe përfshin vlerësimin nga ana e komunitetit së shërbimeve të ofruara në nivel vendor për përmbushjen e 10 prioritetëve të Kontratës Sociale, vlerësimin e këshilltarëve dhe stafit të bashkisë në lidhjen me demokracinë vendore, si dhe gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.

Në Bashkinë Durrës POP u realizua nga Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile.

Puna e Qendrës, organizatave të tjera të shoqërisë civile, pushtetit vendor dhe qendror u drejtua në përgjigje të situatave emergjente të krijuara.

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i demokracisë vendore përmes fuqizimit të mekanizmave qytetarë. Objektiva specifike të tij synojnë të nxisin ndërveprimin dhe dialogun mes qytetarëve dhe autoriteteve vendore, përmes përfshirjes së prioritetëve dhe nevojave të qytetarëve në programet dhe buxhetet vendore, duke krijuar kushte për përmirësime të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit dhe duke fuqizuar në këtë mënyrë bashkëpunimin midis të dyja palëve.

Gjatë kësaj periudhe në zbatimin e POP komuniteti i Bashkisë Durrës, shërbeu si njësi bazë analize për nxitjen e llogaridhënies, transparencës dhe përgjegjshmërisë publike të institucionit të bashkisë. Ai mundësoi monitorimin dhe vlerësimin e performancës së administratës lokale, ndërkohë që ofroi mundësi që bashkia të kuptojë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve.

Gjatë procesit të përpunimit të vlerësimeve janë konsultuar gjerësisht materiale, dokumenta dhe strategji, të tilla si: Strategjia e Zhvillimit të Territorit Bashkisë Durrës, buxheti i bashkisë për vitin 2019-2020, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Ligji 139/2015 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Vetëqeverisjes Vendore”, faqja e internetit e Bashkisë Durrës, Plani përfshirjes sociale për bashkinë Durrës; Vendimet e Këshillit Bashkiak, etj

Bashkia Durrës ka punuar në përmbushje të angazhimeve të Kontratës Sociale dhe për disa nga prioritetet vërehet ecuri e mirë në realizimin e tyre dhe po kështu ka nevojë për fokus në realizimin e të tjerave. Më poshtë Ju paraqesim një përmbledhje të gjetjeve:

- Eshtë punuar për krijimin e mekanizmave që sigurojnë shkëmbimin e informacionit e transparencën e vendimeve ,por duhet vazhduar përditësimi dhe plotësimi i tyre si në faqen web ashtu dhe në këndet e njoftimeve;
- Bashkia ka një strukturë të dedikuar për rininë, por angazhimi për specifikimin e një zëri buxhetor për të rinjtë në buxhetin vjetor që harton Bashkia kërkon akoma angazhim.
- Ngritja e funksionimi i qendrave rinore dhe bibliotekave publike është një prioritet që Bashkia Durrës e ka në fokus, por këto qendra dhe bilblitoeka duhen shtuar si në qytet ashtu dhe në NJA.
- Ka iniciativa për nxitjen e bizneseve të të rinjve dhe grave, por Bashkia dhe në përmbushje të akteve ligjore në fuqi mund të aplikojë më shumë skema mbështetjeje nga buxheti i saj.
- Duhet vazhduar për shtimin e hapësirave të gjelbërta dhe lulishtet ne sheshet e pallateve dhe në lagjet periferike të Durrësit;
- Ndërhyrja për ndërtimin e shkollave e cerdheve të reja, duhet të vazhdojë duke patur parasysh trendin e rritjes së popullsisë;
- Përmiresimi i shërbimit të transportit publik, vendosja e tabelave me orare dhe zbatimi i tyre;
- Zbatimi me korrektesë i akteve ligjore e nënligjore ne fuqi per transportin e fëmijëve që janë me vendbanim të largët nga shkolla;
- Aplikimi i paketave të lehtësimit për kategoritë ne nevojë;
- Ngritja dhe funksionimi i qendrave ditore për kategoritë ne nevoje apo të marxhinalizuara;
- Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje shërbimeve mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruere për viktimat e dhunës në familje.
- Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazine gjinore

Në këtë raport do të lexoni: 1) Metodologjinë e projektit; 2) Kontrata Sociale e Bashkisë Durrës; 3) Përmbledhjen e rezultave të vlerësimit të qytetarëve Durrsakë për qeverisjen vendore në zbatim të Kartës Sociale; 4) Gjetje e rekomandime për të ardhmen.

Metodologjia

POP ka vendosur në qendër të këtij raportimi vetë qytetarët/komunitetin si njësi analize për të nxitur llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë sociale dhe publike të institucioneve vendimarrëse vendore. POP po zbatohet në një nivel shumë të rëndësishëm të qeverisjes, në atë vendor, ku qytetarët janë në kontakt më të drejtpërdrejtë me autoritetet vendimarrëse dhe mbi të gjitha, me shërbimet e ofruara prej tyre.

Procesi mundëson krijimin e dialogut mes komunitetit dhe autoriteteve vendore, duke përballur mundësitë (burimet që kanë në dispozicion autoritetet vendore) me nevojat reale të komunitetit. Zbatimi i tij ndikon në zhvillimin e qeverisjes me pjesëmarrje dhe arritjen e mirëqeverisjes vendore. Duhet të theksojmë gjithashtu se POP nuk duhet kuptuar vetëm si një proces vlerësimi, pasi nëpërmjet tij ndërtohen mënyra e mjete ndërveprimi mes komunitetit, autoriteteve vendore, organizatave të shoqërisë civile etj, duke krijuar kushte për përmirësime të të shërbimeve që i ofrohen komunitetit, duke e fuqizuar atë.

Përfituesit e këtij procesi janë komuniteti dhe autoritet vendore. Procesi i mundëson komunitetit të informohet mbi shërbimet që ofrohen nga autoritetet vendore; të shprehë opinionin e tij mbi cilësinë dhe eficientësinë e tyre; të monitorojë përmbushjen e detyrimeve/angazhimeve të bashkisë; të shprehë opinionin e tij dhe t'u kërkojë atyre përmirësimet e nevojshme. Nga ana tjetër POP i jep mundësinë

autoriteteve vendore të njohin më mirë nevojat dhe prioritetet e komunitetit në përgjithësi, si dhe të grupeve të veçanta të tij; të orientojnë më mirë burimet që kanë në dispozicion në përputhje me këto nevoja dhe prioritetet e komunitetit, të rrisin kapacitetet e tyre, transparencën në qeverisje dhe të përmirësojnë cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve që i ofrojnë komunitetit.

Në Bashkinë Durrës procesi u realizua nëpërmjet disa etapave, të tilla si: (I) vlerësim i monitorim i buxhetit të bashkisë Durrës dhe Vendimeve të Këshillit Bashkiak; (II) vlerësimi komunitar për Kontratën Sociale (3 fokus grupe me qytetare të Bashkisë Durrës në zonën urbane dhe rurale); (III) vlerësim i dokumentacioneve apo raporteve të tjera bazuar në punën e rrjetit POP apo të organizatave të tjera (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte); (IV) Monitorimi i vendimeve të qeverisë në lidhje me përmbushjen e ndonjë prej prioritetëve me buxhet ndihmë për pushtetin vendor, si p.sh mbështetje për ngritje të shkollave, qendrave shëndetësore apo të tjera të kategorive të ngjashme. (V) Monitorim i mediave në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike. dhe (VI) përgatitja e raportit me qëllim institucionalizimin e procesit, advokimin dhe monitorimin.

Kontrata Sociale e Bashkisë Durrës

Për të hartuar “Kontratën Sociale të Bashkisë Durrës”, CSDC Durrës ka zhvilluar në muajin Gusht 2021, 8 fokus grupeve me banorë Durrësit, Katundit të Ri, Manzës, Rrashbullit dhe Sukthit. Forumet kishin si qëllim diskutimin e çështjeve me interes për komunitetet lokale, si dhe identifikimin e prioritetëve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar.

Në secilin prej 8 fokus grupeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, të niveleve të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. 10 prioritetet e Kartës Sociale, si më poshtë u diskutuan nga banoret, ne cilin nivel ishte arritur apo jo nga pushtetit lokal të plotësohej teresit, pjesërisht apo nuk ishte plotësuar dhe opinionin e tyre qytetar për plotësimin e metejshëm.

Prioritet 1: Funksionimi i mekanizmave që sigurojnë shkëmbimin reciprok të informacionit dhe transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak ndaj komunitetit;

Prioritet 2: Specifikimi i një zëri buxhetor për të rinjtë në buxhetin vjetor që harton Bashkia;

Prioritet 3: Ngritja e funksionimi i qendrave rinore dhe bibliotekave publike në Bashkinë Durrës;

Prioritet 4 : Zhvillim i programeve egzistuese për nxitjen e bizneseve të të rinjve dhe grave dhe informim i vazhdueshëm i publikut mbi programet që zhvillon e zbaton Bashkia për nxitjen e punësimit me fokus Të rinjtë, Gratë kryefamiljare, Pjesëtarë madhorë të familjeve me ndihmë ekonomike.

Prioritet 5 : Ngritje dhe zgjerim i hapësirave të gjelbërta në qytet dhe njësitë administrative; ndërhyrje në kanalet kulluese dhe vaditëse në njësitë administrative. Vijimi i investimeve që përmirësojnë

infrastrukturën, rrugët dytësore Shtim i koshave për mbledhjen e mbetjeve urbane dhe tërheqja e tyre nga makina e mbledhjes së mbeturinave të paktën 1 herë në dy ditë në të gjitha lagjet bashkisë Durrës.

Prioritet 6: Përmirësime në infrastrukturën e shkollave (sisteme ngrohje; laboratorë të informatikës) si edhe plotësim i strukturës me personel për pastrimin & ruajtjen e shkollave në Njësitë administrative të Bashkisë Durrës. Rikonstruksion i kopshteve dhe çerdheve në lagjet periferike të qytetit Durrës, në Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Prioritet 7: Përmirësim i cilësisë së transportit publik (Përcaktimi dhe publikimi i orareve të transportit publik; Korrektesë në oraret e mbërritjes në stacion, përmirësim i kushteve higjeno-sanitare, rritja e shpeshtësisë së autobusëve dhe e kohëzgjatjes së këtij shërbimi edhe pas orës 17.00) në Njësitë administrative. Të zgjidhet çështja e transportit të fëmijëve për në shkolla për shkak të distancës së largët nga vendbanim në Rrashbull dhe Sukth.

Prioritet 8: Zgjidhja me prioritet e furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për lagjet e qytetit të Durrësit dhe njërive të tjera administrative **Prioritet 9:** Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë dhe ngritja e shërbimeve të reja sipas nevojave të vlerësuara lagjet e qytetit Durrës në njësitë administrative Manëz, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Prioritet 10: Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje shërbimeve mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruere për viktimat e dhunës në familje.

Përmbledhje e rezultateve

Siç u shpjegua më sipër në raport, në proces u përfshinë 100 qytetarët në nga qyteti i Durrësit dhe në njësitë administrative. Më poshtë parqesim një përmbledhje të rezultateve e dala dhe analizuara nga ky vlerësim. Në fokus grupet pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht 10 prioritetet që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:

1. Shërbimet publike;
2. Zhvillimi ekonomik vendor;
3. Dimensioni social dhe
4. Demokracia vendore

Prioritet 1: Funksionimi i mekanizmave që sigurojnë shkëmbimin reciprok të informacionit dhe transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak ndaj komunitetit;

Transparenca në vendim-marrje

Publikimi i vendimeve dhe dokumentacioneve të tjera: Qytetarët e Durrësit e vlerësojnë shumë të rëndësishme transparencën në vendimmarrje.

Në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe transparencën nga ana e Bashkisë, pjesa më e madhe e qytetarëve u shprehën se kishte mungesë informacioni dhe indiferencë nga ana e Bashkisë. Sipas tyre, informacionin në lidhje me thirrjet për dëgjesa publike, mund ta merrnin vetëm tek zyrat e informacionit pranë Bashkisë ose nëpërmjet OJF, nuk publikohen në faqen zyrtare. Edhe ato informacione të cilat publikohen, kanë një terminologji të papërshtatshme për publikun e thjeshtë, nuk është e kuptueshme. Nga ana tjetër kishte dhe individë, të cilët shprehen se mosinformimi është dhe përgjegjësi e vetë qytetarit, jo vetëm detyrë e Bashkisë. Në përfundim të diskutimit të kësaj pike, 70% prej qytetarëve mendonin se nuk është plotësuar fare, ndërsa 30% mendonin që pjesërisht. Po kështu në njësitë administrative duhet më shumë vëmendje për këndet e shpalljeve të vendimeve apo njoftimeve. Në njësitë administrative Manëz dhe Sukth nuk ka as kënd për shpalljen e vendimeve apo njoftimeve publike.

Informimi dhe Komunikimi: Bashkia ka të ndërtuar një sistem për ta bërë informacionin dhe shërbimet të aksesueshme për qytetarët. Sipas banorëve të lagjes Spitalle citojnë se bashkia nuk ka marrë ndonjë masë për shkëmbimin e informacionit apo transparencën e vendimeve për komunitetin, përveçse tek zyrat e informacionit në Bashki dhe në website e saj, edhe aty nuk janë të publikuara të gjitha dhe është e paaksesueshme për moshat e treta.

Sipas qytetareve të Njesise Administrative Manëz citojnë se: Gjithashtu dhe për problematika që janë ngritur dhe adresuar në zyrën e informacionit nuk është marrë një përgjigje, si p.sh.: afati i përfundimit të shkollës që po rindërtohet në Kullë, pasi ka kaluar ai i pasqyruar në fletën e projektit. Në fshatin Borç nuk kanë një zyrë apo përfaqësi nga Bashkia, ku mund të drejtohen për problematikat e tyre apo informacione. Disa shprehen që Bashkia ka treguar indiferencë dhe në rastet kur problematikat janë adresuar, duke mos kthyer përgjigje për shqetësimet e ngritura.

Zyra e informacionit të Bashkisë dhe ADISA asistojnë qytetarët në këtë proces. Vazhdon të mbetet shqetësim aksesimi i informacionit në NJA. Po kështu një tjetër problematikë e identifikuar në forumin e lagjeve të qytetit Durrës lidhet me personat me aftësi të kufizuar që sipas tyre janë të limituar nga marrja e informacionit.

Pjesëmarrja Në Vendimarrje: Nga diskutimet mbi këtë çështje në takimet e zhvilluara me qytetarët dhe stafin e bashkisë Durrës, konkludohet se Bashkia Durrës ndërmerr procese konsultimi me komunitetin për vendimarrjet më të rëndësishme, porse mekanizmi që përdor për të nxitur pjesëmarrjen e komunitetit në to nuk është jo vetëm i unifikuar, por as edhe tërësisht efektiv. Stafi i Bashkisë Durrës shfaq konfuzion kur pyetet për strukturën përgjegjëse organizimin e BP-së, të cilat variojnë nga titullari i institucionit dhe deri tek organizatat e shoqërisë civile. Disa prej të intervistuarve mendojnë që struktura përgjegjëse është Drejtoria e Zhvillim Koordinimit dhe të tjerë e mendojnë si përgjegjësi të tre drejtorive së bashku: asaj të Zhvillim Koordinimit, Financave/Buxhetit dhe GMS.

Duket se monitorimi dhe vlerësimi i proceseve vijon të mbetet sfidë për bashkitë në vend. Edhe në Bashkinë Durrës nuk ka një sistem. Vërehet sërish konfuzion midis procesit BP dhe atij të Buxhetit Afatmesëm të bashkisë, i cili është parë me prioritet me hyrjen në fuqi të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore.

Qytetarët dhe Punonjësit e Bashkisë Durrës vlerësojnë si sfidë pjesëmarrjen e ulët të grupeve të interesit, grave, të rinjve, komuniteteve të marxhinalizuara, e sidomos në zonat rurale.

Anëtarët e KB shprehen se ka nevojë për përmirësimin e proceseve të konsultimit, theksohet ndjeshëm rritja e bashkëpunimit Bashki-Këshill Bashkiak-komunitet, por edhe bashkëpunimi mes forcave politike në këshill, rritja e kapaciteteve si të anëtarëve të këshillit por edhe të stafit të bashkisë. Ndër nevojat e tjera që ata listojë si të rëndësishme mund të përmendim:

- Rritje e gjithëpërfshirjes qytetare në procese të konsultimit publik, e sidomos aktivizim nga shoqëria civile;
- Rritje të transparencës dhe mirëorganizim të procesit të BP

Priotitet 2: Specifikimi i një zëri buxhetor për të rinjtë në buxhetin vjetor që harton Bashkia;

Nga analiza e buxhetit dhe vendimeve të këshillit bashkiak, ky prioritet mbetet i parealizuar. Bashkia në bashkëpunim me organizata të ndryshme ka aplikuar iniciativa sporadike, por nuk ka akoma një zë buxhetor për të rinjtë edhe pse ka një strukturë që ka si qëllim angazhimin me të rinjtë. Ligji @Per Rininë kërkon dhe ngritjen e një bordi rinor si strukturë konsultuese për Kryetarin e Bashkisë.

Prioritet 3: Ngritja e funksionimi i qendrave rinore dhe bibliotekave publike në Bashkinë Durrës;

Qytetarët dhe stafi Bashkisë i vlerësojnë shumë të rëndësishme mjediset për rininë e ngritjen e tyre në njësi administrative po kështu dhe krijimi i bibliotekave publike përveç atyre të shkollave. *Për te rinjte dhe banoret e Njesise Administrative Sukth projektet rinore apo një buxhet të vendosur në dispozicion për këtë motiv, nuk kishin informacion. E shohin të nevojshme që të ketë të tilla, në mënyrë që të rinjtë e zones së tyre ta investojnë energjinë që i karakterizon dhe kohën e lirë, në mënyrë të shëndetshme. E njëjta gjë vlen dhe për qendrat rinore dhe bibliotekat. Nëse do të kishte një buxhet të vendosur në dispozicion për rininë, do të ishte menduar dhe investuar dhe për qendrat rinore. Biblioteka ndërkohë nuk ka asnjë, përveçse në shkolla. Gjithashtu, të mos paturit njohuri në lidhje me këtë pjesë, e shohin dhe si problematikë që ka ardhur si pasojë e mungesës së komunikimit reciprok me Bashkinë. Problematikat janë rrjedhoja të njëra-tjetrës. Prioriteti aspak i plotësuar.*

Prioritet 4 : Zhvillim i programeve egzistuese për nxitjen e bizneseve të të rinjve dhe grave dhe informim i vazhdueshëm i publikut mbi programet që zhvillon e zbaton Bashkia për nxitjen e punësimit me fokus Të rinjtë, Gratë kryefamiljare, Pjesëtarë madhorë të familjeve me ndihmë ekonomike.

Nxitja e bizneseve të të rinjve dhe grave: Si një nga funksionet e specifikuar edhe në ligjin për vetëqeverisjen vendore, ky prioritet mbetet kryesor në bashkinë Durrës. *Banoret shprehen se nuk kanë informacion për programe që nxisin punësimin apo zhvillimin e bizneseve për grupe të ndryshme, si: të rinjtë, gratë kryefamiljare, familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike etj. Prioriteti aspak i plotësuar.*

Nxitja e punësimit- Në lidhje me programet që synojnë nxitjen e punësimit të grupeve të marxhinalizuara, qytetarët shprehen se nuk kanë asnjë informacion nëse ka ndonjë të tillë ekzistues apo buxhet të

planifikuar për këto programe. Ata sugjerojnë që Bashkia duhet të zhvillojë takime me këto grupe dhe bizneset që mund të jenë pjesë e projekteve në të ardhmen. Duke qenë se nuk kishin asnjë lloj qasje në këto lloj programesh apo njohuri rreth tyre, rrjedhimisht për ta kjo ishte një pikë e paplotësuar.

Prioritet 5 : Ngritje dhe zgjerim i hapësirave të gjelbërta në qytet dhe njësitë administrative; ndërhyrje në kanalet kulluese dhe vaditëse në njësitë administrative. Vijimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore Shtim i koshave për mbledhjen e mbetjeve urbane dhe tërheqja e tyre nga makina e mbledhjes së mbeturinave të paktën 1 herë në dy ditë në të gjitha lagjet bashkisë Durrës. Në shkollën 9-vjeçare “Qemal Mici”ekzistojne koshat e mbeturinave nga të dyja anët. Jo vetëm që nuk pastrohen rregullisht, por dhe kur pastrohen kanë aromë të padurueshme që ndonjëherë vjen deri tek klasat e katit të pare-ciltojnë banoret.

Për hapësirat e gjelbërta, studentët shprehen se jo vetëm që nuk janë zgjeruar, por dhe ato që janë po betonizohen, në Durrës, Shijak dhe Xhafzotaj. Për kanalet kulluese shprehen se funksionojnë vetëm në qendër të qytetit.

Gjelbërimi

Mungesa e parqeve për fëmijët i detyron prindërit t’i çojnë fëmijët në qendra tregtare të qytetit për t’i argëtuar. Lulishtet e vogla edhe në sheshet e pallateve të qytetit konsiderohen emergjente. *Për sa u përket hapësirave të gjelbërta, sipas tyre nuk ka mjaftueshëm. Në zonat e tyre nuk ka fare. Përmbytja u ngrit sërish si problematikë: në Porto Romano dhe ish-Kënetë ka përmbytje sa herë që ka rreshje shiu. Koshat e mbeturinave mbeteshin problematikë. Në lagjen 17, për shkak se po shtrohen rrugët, koshat janë hequr fare, ndërsa në zonën e ish-Kënetës, disa ishin hequr për shkak se janë dëmtuar, por nuk janë zëvendësuar. Në afërsi të shkollës “Qemal Mici” ka kosha nga të dyja anët. Nxënësit shprehen se nuk zbrazen rregullisht, por edhe kur zbrazen, nuk pastrohen dhe aroma mbetet. Kjo bëhet shqetësuese për klasat në katet e para, pasi kjo aromë mbërrin deri në ambientet e tyre. Gjithashtu njëri prej pjesëmarrësve u shpreh se e sheh si të palogjikshme vendosjen e koshave, shepesh, në afërsi të vijave të bardha.*

Kanalet kulluese/vaditëse

Në të gjitha takimet e zhvilluara në Manëz, Katund të Ri, Rashbull dhe Sukth u theksua se cilësia e kanaleve kulluese dhe vaditëse lë shumë për të dëshiruar. Kanalet kulluese në përgjithësi nuk janë funksionale duke shkaktuar kështu edhe përmbytje të herëpashershme. Në Manëz, vazhdon të mbetet problem mos pastrimi i kanaleve ekzistuese të kullimit, por edhe mungesa e kanaleve të kullimit në fshatra. Kanali në fshatin Shkallë, edhe pse me ndërhyrje të vogla mbetet problematik, ndërhyrja në të do të zgjidhte këtë shqetësim për një zonë shumë të madhe. Pothuaj e njëjta situatë paraqitet edhe në NJA-të e tjera.

Infrastrukturë, rrugë dhe trotuare

Infrastruktura rrugore dhe trotuaret mbeten problematike në disa zona. Në Durrës vazhdon të mbetet problem ndërhyrja në zonën e Spitalit të Durrësit. Po kështu kërkohet monitorim e supervizim më i mirë në rastet që për ndërhyrje të ndryshme rrugët hapen dhe në përfundim të ndërhyrjeve të tyre, ato nuk

risistemohen tërësisht. Gjerësia dhe përshtatshmëria e trotuareve, dhe sinjalistika rrugore mbetet problem për banorët e lagjes 14. Në disa zona Bashkia Durrës ka bërë një punë të mirë në rrugët lidhëse me NJA-të por duhet vazhduar me ndërhyrje në rrugët e fshatrave dhe në rrugët bujqësore, në Sukth e Rashbull.

NDRIÇIMI

Shqetësim për qytetarët përbën ndriçimi në zonat larg qendrës së qytetit. Bashkia ka realizuar disa ndërhyrje në segmente të vogla por puna duhet të vazhdojë sidomos në periferi ku në disa zona mungojnë shtyllat. Ndricimi u konsiderua shumë i rëndësishëm edhe për sigurinë e qytetarëve, sidomos nga gratë dhe vajzat.

Pastrimi

Në thelb, qyteti i Durrësit pastrohet çdo ditë, theksuan pjesëmarrësit në Forumet e lagjeve të Durrësit, por ka nevojë për të shtuar numrin e koshave për mbetjet urbane. Koshat egzistues janë të vjetër, me rrota të prishura dhe pa kapak. Ndërhyrje e menjëherëshme kërkohet në zonën arkeologjike dhe muzeale të Bashkisë Durrës, që ka vetëm 3 kosha për një zonë me mbi 500 banorë. Në forumin e Manzës u theksua se pastrimi bëhet nga vetë banorët. Mbeturinat lihen në rrugët kryesore, makina e pastrimit merrato që janë në rrugën kryesore dhe jo në të gjitha rrugët. Mungesa e koshave për grumbullimin e mbetjeve u theksua edhe në Katudin e Ri. Mungesa e tyre nxiti banorët që ti hedhin mbetjet në lum e për rrjedhojë shpesh përjetojnë përmytjen e lumit Erzen dhe dëmtim të tokave bujqësore. Numri i vogël i koshave të mbetjeve dhe distanca e madhe e atyre, që janë në vendbanimet u theksua në forumin e Sukthit. Të dyja këto ndikojnë që banorët t'i hedhin mbetjet vend e pa vend apo t'i derdhin në kanale që më pas nuk pastrohen.

Pyjet dhe kullotat

Në Forumet e Manzës, Katundit të Ri, Rashbullit dhe Sukthit diskutimi u fokusua tek drutë e zjarrit. Banorët i blejnë drutë për ti përdorur për ngrohje dhe vlerësojnë se çmimi i tyre është i lartë.

Prioritet 6: Përmirësime në infrastrukturën e shkollave (sisteme ngrohje; laboratorë të informatikës) si edhe plotësim i strukturës me personel për pastrimin & ruajtjen e shkollave në Njësitë administrative të Bashkisë Durrës. Rikonstrukcion i kopshteve dhe çerdheve në lagjet periferike të qytetit Durrës, në Sukth, Katund i Ri dhe Rashbull.

Shkollat

Qytetarët vlerësuan ndërhyrjet e përvitëshme që ka kryer Bashkia për rehabilitimin e shkollave si në qendër edhe në zonat periferike, megjithatë ka nevoja të vazhdueshme për infrastrukturë brenda shkollave egzistuese. Këto përfshijnë kryesisht sisteme ngrohje, terrene sportive dhe laboratorë të informatikës. Në forumet e Sukthit dhe Rashbullit u theksua se shkollat egzistuese janë të amortizuara dhe kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme. Përveç infrastrukturës së papërshtatëshme të shkollave, pjesëmarrësit në forumin e Katundit të Ri theksuan edhe mungesën e personelit ndihmës në shkolla, kryesisht personel

për pastrimin, ruajtjen e shkollës, sikurse dhe mungesën e psikologut. Shkollat nuk janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Vlen të theksojmë edhe punën e bërë për rehabilitimin e shkollave të dëmtuara nga tërmeti.

Kopshte dhe çerdhe

Në takime u theksua nevoja për përmirësime në infrastrukturën e kopshteve dhe çerdheve. Sa më shumë i largohemi qendrës së Bashkisë, aq më shumë shtohet nevoja për përmirësimin e kushteve. Gjithashtu u kërkua vëmendje edhe për ndërtimin e çerdheve të reja.

Prioritet 7: Përmirësim i cilësisë së transportit publik (Përcaktimi dhe publikimi i orareve të transportit publik; Korrektesë në oraret e mbërritjes në stacion, përmirësim i kushteve higjeno-sanitare, rritja e shpeshtësisë së autobuzëve dhe e kohëzgjatjes së këtij shërbimi edhe pas orës 17.00) në Njësitë administrative. Të zgjidhet çështja e transportit të fëmijëve për në shkolla për shkak të distancës së largët nga vendbanim në Rrashbull dhe Sukth.

Transporti publik

Në lidhje me transportin publik, shqetësimi i parë që u shpreh ishte për linjën e universitetit. Gjatë stinës së verës, kur studentëve u duhej të shkonin në ambjentet e universitetit për regjistrime apo riprovime, nuk kishte autobuza. Përgjatë vitit akademik ishte problem shpeshtësia ose numri i autobuzëve, urbane mbushej plot që në dy stacionet e para dhe nuk ndalonte në stacionet e tjera, duke bërë që studentët të shkonin në leksione me vonesë ose të bënin rrugë në këmbë deri tek stacionet e para. Gjithashtu dhe linja Durrës-Plepa kishte pak a shumë të njëjtën problematikë, ndalonte në stacionet përkatëse, por kishte raste që dhe jo, për shkak të numrit shumë të madh të pasagjerëve. Tabela për oraret nuk ka në asnjë stacion të asnjë linje. Autobuzi i universitetit nuk ka tabelë treguese për stacion autobuzi në çdo stacion. As në zonën e Shijakut. Pjesa më e madhe e studentëve u duhej të merrnin nga dy urbane çdo herë që shkojnë në leksion, prandaj propozuan që të shihej mundësia e një aboneje për studentët, e cila të jetë e përdorshme për çdo linjë. Gjithashtu dhe shtimi i numrit të autobuzëve në oraret e mëngjesit. Në aspektin e përmirësimit të prioritetit të mësipërm, u pa si aspak i plotësuar.

Transporti publik nuk është i aksesueshëm për PAK. Nuk ka një vend të veçantë, ku të ulen. Nuk ka rampa. Një prind shprehet që u detyrua të blinte makinë, pasi transporti publik nuk është praktik për përdorim të përditshëm me fëmijën e saj. Prindërit sugjerojnë që të ketë abone apo librezë që të mbulojë të paktën shpenzimet e biletave të fëmijëve.

Prioritet 8: Zgjidhja me prioritet e furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për lagjet e qytetit të Durrësit dhe njësive të tjera administrative

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Rregullimi i infrastrukturës së ujërave të bardha dhe atyre të zeza në lagjet e qytetit të Durrësit është një tjetër prioritet i dalë nga forumet e zhvilluara në këtë territor.

Furnizimi me ujë nuk ishte i shpeshtë, p.sh. në Lagjen Guza, vinte vetëm në mëngjes, 3 orë dhe më pas nuk kishte gjatë gjithë ditës; në Lagjen e Mesme, Sukth, vinte një ditë po, një ditë jo. Nuk ka kanalizime në zonë. Kanalizimet për ujërat e zeza janë të improvizuara nga vetë familjet pranë banesave të tyre. Për koshat shprehen që nuk pastrohen mjaftueshëm, vetëm ditëve të Hëna. Banorët shpesh detyrohen t'i mbajnë plehrat në shtëpi gjithë javën

Prioritet 9: Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë dhe ngritja e shërbimeve të reja sipas nevojave të vlerësuara lagjet e qytetit Durrës në njësitë administrative Manëz, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Programe dhe shërbime të kujdesit shoqëror për individët në nevojë

Nevoja për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Durrës u shpreh qartë në të gjitha fokus grupet e organizuara. *Shërbime sociale për individët në nevojë nuk ka, as qendra rezidenciale për të moshuarit. Për të adresuar të tilla problematika, duhet t'u drejtohet njësisë administrative, të cilat janë larg, por gjithashtu nuk dinë kujt t'i drejtohe as atje, pasi punonjësit socialë apo të tjerë aktorë, nuk u janë prezantuar asnjëherë. Në komunitetin e tyre, kategoria që u duket më në nevojë dhe që kërkon vëmendjen e këtij shërbimi, janë fëmijët shprehen banoret.*

Tek pjesa e shërbimeve shoqërore, u ritheksua nevoja e një qendre rezidenciale ditore. Kjo jo vetëm për shkak të punësimit të prindërve, por dhe për efekt socializimi. Gjithashtu shihen të nevojshme dhe qendra, ku organizohen aktivitete dhe shërbime për moshat më të mëdha. Tek ujjësjellësi, ku ndodhet Qendra Komunitare e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, ndodhen hapsira prapa qendrës, të cilat janë të zëna nga magazina që nuk përdoren. Prindërit janë interesuar dhe ka rezultuar që kjo pronë është shtetërore dhe, janë ofruar vullnetarisht të ndihmojnë në pastrimin e vendit për t'u bërë një qendër rezidenciale me infrastrukturë më të zgjeruar dhe staf të shtuar, nëse është e mundur të merret leje dhe të vendoset një buxhet në dispozicion për këtë. Prindërit kanë hasur vështirësi dhe me përfitimin e strehimit social, me argumentin që nuk përmbushin kriteret dhe pse sipas tyre janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe njëkohësisht me qera. Ata mendojnë se pyetsori i bërë nga shërbimi social, pyetje të cilat nuk përshtaten dhe janë paradoksale, prandaj duan një rishikim të tyre. Tjetër problematikë ishte heqja e kujdestarisë në moshën 18 vjeçare, me pretekstin që janë të aftë për të qenë të pavarur, gjë e cila për prindërit është e palogjikshme dhe kërkojnë të rishikohet si pikë.

Prioritet 10: Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje shërbimeve mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruere për viktimat e dhunës në familje.

Pjesëmarrja e grave në vendimarrje

Pjesëmarrësit në takimet e zhvilluara në NJA shprehen se janë të pa informuar mbi nivelin e përfaqësimit të grave në vendimarrjet në Bashki, si në këshillin bashkiak, ashtu edhe në administratën e Bashkisë. Në

këndvështrimin e tyre kjo ndodh edhe sepse asnjë këshilltar/e nuk është përfshirë me këto komunitete për t'i dëgjuar apo konsultuar. Në qytetin e Durrësit u theksua nga stafi bashkisë nevoja e shtimit të numrit të garve punonjëse në administratë.

Programet dhe shërbime të bashkisë mbi adresimin e dhunës në familje

Diskutimet në lidhje me programet dhe shërbimet e Bashkisë për adresimin e dhunës në familje treguan se informimi i komuniteteve për këtë çështje në zona të ndryshme të Bashkisë është i ndryshëm. Në forumet e lagjeve të Durrësit, Katundit të Ri dhe Rrëshbullit pjesëmarrësit ishin në dijeni si të programeve ashtu dhe shërbimeve të Bashkisë. Në forumet e Manzes dhe Sukthit pjesëmarrësit ishin të informuar mbi përpjekjet e Bashkisë për adresimin e dhunës.

Romët dhe egjiptianët

Në forumet e zhvilluara ku përfshihen zona që kanë komunitet rom dhe egjiptian, pjesëmarrësit ishin në dijeni të egzistencës së një Plani specifik të Bashkisë për këtë komunitet dhe të faktit që Bashkia ofron shërbime specifike për ta. Megjithatë atë vlerësuan se angazhimi i Bashkisë për riintegrimin dhe fuqizimin e këtij komuniteti duhet të vazhdojë.

Rekomandime për Bashkinë Durrës

- **Prioritet 1:** Funksionimi i mekanizmave që sigurojnë shkëmbimin reciprok të informacionit dhe transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak ndaj komunitetit
- Përditësim dhe plotësim i informacioneve të publikuara në faqen zyrtare në ëeb të Bashkisë Durrës në zbatim të akteve ligjore në fuqi;
- Plotësim i regjistrat elektronik;
- Krijimi i një procedure të institucionalizuar për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje.
- **Prioritet 2:** Specifikimi i një zëri buxhetor për të rinjtë në buxhetin vjetor që harton Bashkia.
- Në përgatitjen e buxhetit, në programin përkatës bashkia duhet të shikojë mundësinë për patjen e një zëri specifik buxhetor dedikuar rinisë.
- Ndërkohe në bashki duhet të funksionojë rregullisht dhe Bordi Rinore, kërkesë e ligjit të Rinisë. Krijimi i kësaj strukture do të shërbejë edhe zbatimit të prioritetit të kontratës sociale.
- **Prioritet 3:** Ngritja e funksionimi i qendrave rinore dhe bibliotekave publike në Bashkinë Durrës
- Mjediset për të rinjtë janë shumë të rëndësishme. Ngritja e funksionimi i qendrave rinore edhe shtrirja e tyre edhe në NJA, duke adaptuar edhe mjedise apo gosina aktuale në pronësi të bashkisë.
- Hapja e bibliotekave dhe mirëfunksionimi i tyre si mjedise sociale për të rinjtë
- **Prioritet 4:** Zhvillim i programeve egzistuese për nxitjen e bizneseve të të rinjve dhe grave dhe informim i vazhdueshëm i publikut mbi programet që zhvillon e zbaton Bashkia për nxitjen e punësimit; me fokus Të rinjtë; *Gratë kryefamiljare; Pjesëtarë madhorë të familjeve me ndihmë ekonomike*.
- Të miratohen në buxhetin e bashkisë një shumë e dedikuar e granteve për nxitjen e nxitjen e biznesit të vogël;
- Aplikimi i incentivave fiskale për grate dhe të rinjtë e të rejtat që hapin biznese të reja në Durrës;
- Krijimi i një structure forum/ bord/këshill për zhvillimin ekonomik
- **Prioritet 5:** Ngritje dhe zgjerim i hapësirave të gjelbërta në qytet dhe njësitë administrative; ndërhyrje në kanalet kulluese dhe vaditëse në njësitë administrative. Vijimi i investimeve që

përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore. Shtim i koshave për mbledhjen e mbetjeve urbane dhe tërheqja e tyre nga makina e mbledhjes së mbeturinave të paktën 1 herë në dy ditë në të gjitha lagjet bashkisë Durrës.

- Vazhdimi i punës për shtimin e hapësirave të gjelbërta dhe lulishtet në sheshet e pallateve dhe në lagjet periferike të Durrësit;
- Mirëmbajtja e kanaleve kulluese dhe vaditëse dhe hapja e kanaleve të reja duhet të shihet me prioritet. Ndërtimi dhe miratimi i një plani veprimi afatmesëm për këtë fushë do të mundësonte ndërhyrje të qëndrueshme.
- Shtimi i koshave në disa zona të qytetit dhe në NJA.
- **Prioritet 6:** Përmirësime në infrastrukturën e shkollave (*sisteme ngrohje; laboratorë të informatikës*) si edhe plotësim i strukturës me personel për pastrimin & ruajtjen e shkollave në Njësitë administrative të Bashkisë Durrës. Rikonstruksion i kopshteve dhe çerdheve në lagjet periferike të qytetit Durrës, në Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.
- Vazhdimi i punës për mirëmbajtjen vjetore të shkollave;
- Ndërhyrja sipas një plani për ndërtimin e shkollave e çerdheve të reja, duke patur parasysh trendin e rritjes së popullsisë;
- **Prioritet 7:** Përmirësim i cilësisë së transportit publik
- Përmirësimi i shërbimit të transportit publik, vendosja e tabelave me orare dhe zbatimi i tyre;
- Zbatimi me korrektesë i akteve ligjore e nënligjore në fuqi për transportin e fëmijëve që janë me vendbanim të largët nga shkolla;
- **Prioritet 8 :** Zgjidhja me prioritet e furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për lagjet e qytetit të Durrësit dhe njësitë të tjera administrative
- Ndërhyrje për përmirësimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në lagjet e Durrësit;
- Përmirësim i furnizimit me ujë të banorëve në NJA
- **Prioritet 9:** Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë dhe ngritja e shërbimeve të reja sipas nevojave të vlerësuara lagjet e qytetit Durrës në njësitë administrative Manëz, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.
- Aplikimi i paketave të lehtësimit për kategoritë në nevojë;
- Ngritja dhe funksionimi i qendrave ditore për kategoritë në nevojë apo të marxhinalizuara;
- **Prioritet 10:** Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje shërbimeve mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruere për viktimat e dhunës në familje.
- Përditësimi i planit të Perfshirjes Sociale
- Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazine gjinore

Aneksë

Anex 1

Në takimet e kryera me grupet me qytetarë të Bashkisë Durrës, morën pjesë në total 100 persona, të Njësive të ndryshme Administrative, konkretisht: Durrës, Sukth (Kullë), Katund i Ri, Rrashbull, Manëz. Qytetarët ishin të grupmoshave të ndryshme dhe statuseve të ndryshme (studentë, të punësuar/papunësuar, pensionistë etj.). Nga kjo pikëpamje, të përkthyer në grafikë edhe në formë numerike. Këto të dhëna janë gjeneruar nga listëpjesëmarrjet e takimeve.

Siç mund të shihet dhe nga grafikët, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë të rinj të grupmoshës nga 18 deri në 25 vjeç. Kjo pasohet nga qytetarë me statusin “i papunë” dhe më pas “të punësuar” dhe “pensionistë”. Edhe pse në grafikë është realizuar kjo ndarje, nuk përjashtohen dhe persona të cilët bëjnë pjesë në statuse të tjera apo në të dyja statutet njëkohësisht (p.sh.: edhe student, edhe i punësuar).




Fig. 1 Numri i pjesëmarrësve

Fokus grupet përbëheshin nga shumëllojshmëri pjesëmarrësish aktivë, gjë që i bën përfundimet më të vlefshme dhe aktuale. Përpjekja që të kishim një pjesëmarrje të tillë u bë ndër të tjera dhe për gjithëpërfshirje të problematikave, në fokus të diskutimit të ishte çdo mendim dhe sugjerim, në raport me moshat dhe statutet e ndryshme.

Mosha e pjesëmarrësve, siç u theksua dhe më sipër varjonte. Duke qenë se kishte numër të madh nxënësish e studentësh, e nga ana tjetër anëtarë të moshave më të rritura të komunitetit, si prindër dhe pensionistë, mund të thuhet se raporti moshor ka qenë thuajse i barabartë mes moshave të reja dhe moshave të mesme. Mosha e tretë ishte më pak e pranishme, por duke qenë se u vu re që hasnin thuajse të njëjtat problematika në çdo takim që shpreheshin kur ishin të pranishëm kjo grupmoshë, edhe ky numër i vogël mund të quhet si përfaqësues i popullatës.

Takimet janë zhvilluar qëllimisht në Njësi Administrative të ndryshme dhe me grupmosha e gjini të ndryshme, në mënyrë që të ketë shumëllojshmëri mendimesh. Më specifikisht, këto diferenca do të trajtohen më poshtë.

1. Prioritetet sipas moshës

Moshat e reja, të cilat përbëheshin kryesisht nga nxënësit dhe studentët, fokus më të madh kishin infrastrukturën e mjedisve shkollore e akademike, si dhe transportin publik. Duke qenë në një fazë të jetës ku arsimi është prioritar për ta, mund të thuhet që këto rezultate vijnë dhe si pasojë e nivelit të arsimimit. Nxënësit shpreheshin se do të dëshironin të kishte numër më të madh bibliotekash, përveç asaj publike dhe atyre në shkolla, sidomos ata të cilët banonin në zona rurale. Ndërsa për bibliotekat e shkollave dëshironin të investohej në pasurimin e tyre me libra të rinj periodikisht. E njëjta gjë u shpreh dhe nga të rinjtë studentë. Këta të fundit, ata që studionin në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, dëshironin të merrej nën vëmendje linja e transportit të universitetit, shtimi i numrit të autobuzëve dhe rrjedhimisht, rritja e shpeshtësisë së tyre. Për ta të rëndësishme janë edhe qendrat rinore.

Moshat e mesme, pjesa më e madhe duke qenë prindër, mbanin dhe peshën e problematikave të fëmijëve. Ishin të shqetësuar për infrastrukturën e shkollës dhe transportit, më tepër ata që ishin banues në zona rurale. Përpos kësaj, i jepnin rëndësi të madhe dhe problemeve ekonomike, nxitjes së bizneseve dhe problemeve mjedisore, në varësi të zonës. Disa kërkonin vëmendje për rindërtimin apo rikonstruktimin e ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti i 2019, ndërhyrje në kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza dhe hapësirat e argëtimit.

Këto të fundit theksoheshin dhe nga moshat e treta. Sidomos çështjet mjedisore. Për ta ishte e rëndësishme jo vetëm zgjidhja e problematikave të mjedisit, por dhe shtimi i hapësirave të gjelbërta, në mënyrë që të kishin ku të kalonin një pjesë të ditës së tyre.

2. Prioritetet sipas gjinisë

Në raportin meshkuj femra, shihet që nuk ka shumë dallime në prioritetet që ata kanë. Të dyja palët janë të fokusuara në pjesën e rindërtimit dhe rikonstruktimit të godinave të dëmtuara nga tërmeti, si banesat ku jetojnë, ashtu dhe shkollat. Po ashtu, për të dyja gjinitë është i rëndësishëm shtimi i hapësirave të gjelbërta dhe argëtuese. E njëjta gjë vlen dhe për programet e biznesit, meshkujt ishin të interesuar pasi, si kryefamiljarë, kishin përgjegjësi më të madhe nga ana ekonomike, ndërsa femrat interesoheshin për programet e nxitjes së punësimit, duke patur parasysh vështirësitë ekonomike që ndeshnin në familje. I njëjti raport shihet edhe në problematikat që janë hasur me transportin. Një pjesë e përdornin për punë, shkollë, disa shoqëronin fëmijët në shkollë, por në të gjitha rastet kishin të njëjtat mendime dhe kërkesa. Për sa i përket sektorit të shërbimeve sociale, sërish mund të thuhet e njëjta gjë. Në varësi të problematikave personale, ndryshnte rëndësia që i jepej kësaj pjese, por nga ana gjinore nuk kishte asnjë dallim.

3. Sugjerime dhe mendime specifike të cituara nga qytetarët e Bashkisë Durrës:

1. Faqja zyrtare e Bashkisë të përeditësohet rregullisht me informacionet e reja, kalendaret e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe dëgjesave publike dhe, të përdoret terminologji më e thjeshtë, e kuptueshme për publikun e gjerë.
2. Të vendosen rampa në ndërtesat e institucioneve publike, mjetet e transportit publik dhe semaforët me zë.
3. Hapja dhe shtimi i qendrave rinore, jo vetëm në qytete, por dhe në zonat rurale.
4. Shkollat të shërbejnë si qendra komunitare në oraret pas mësimi.
5. Të krijohen hapësira sportive dhe argëtimi për çdo grupmoshë.
6. Duhet të vendosen fonde për rikonstruktimin e bibliotekës publike, jo vetëm në infrastrukturë, por dhe në pasurimin e saj me libra.
7. Në shkollat 9-vjeçare duhet të ketë shtim të stafit sanitar dhe të vendosen roje.
8. Në fshatra nuk kemi një vend ku të drejtohem, një zyrë përfaqësie nga Bashkia.
9. Të rehabilitohen kanalet ujëmbledhëse të zonës, pasi lumi Erzen del nga shtrati dhe krijon përmytje.
10. Të investohet në kanalizimet e ujerave të zeza.
11. Përmytjet e shkaktuara na kanë dëmtuar edhe nga ana e shëndetit mendor, jemi në stres dhe frikë se çfarë mund të ndodhë.
12. T'u kushtohet vëmendje pallateve të dëmtuara nga tërmeti, janë lënë pas dore.
13. Numri i koshave të mbeturinave është i pamjaftueshëm.
14. Koshat nuk pastrohen rregullisht. Shpesh i vendosin zjarrin dhe krijon edhe ndotje në ajër.
15. Në shkollën 9-vjeçare "Qemal Mici" kemi kosha mbeturinash nga të dyja anët. Jo vetëm që nuk pastrohen rregullisht, por dhe kur pastrohen kanë aromë të padurueshme që ndonjëherë vjen deri tek klasat e katit të parë.
16. Realizimi i mësimi me turne është i papërshtatshëm, mësimi nuk zhvillohet si duhet. Ka mungesë ambjentesh dhe turni i dytë mbaron shumë vonë, nuk është e përballueshme nga fëmijët.
17. Afati i përfundimit të rindërtimit të shkollës në Kullë është shtyrë disa herë. Nuk e dimë kur do të mbarojë që dhe ne si staf të organizohemi me ambjentet ku do të kryhet mësimi deri në përfundimin e ndërtimeve.
18. Kemi drejtuar disa kërkesa në Bashki për të marrë informacion kur do të përfundojë rindërtimi, na thanë në Shtator, por Shtatori kaloi dhe shkolla akoma nuk ka përfunduar. (Kullë)
19. Duhet të shtohet numri i kopshteve dhe çerdheve në zonat rurale, pas i numri i tyre nuk është në raport të drejtë me numrin e fëmijëve. Për këtë arsye jemi të detyruar të shkojmë në fshatrat përreth dhe është problematik dhe transporti. Akoma më e vështirë bëhet për nënat me dy fëmijë.
20. Nuk kemi transport publik të rregullt. As stacione nuk ka. Oraret variojnë dhe nuk ka tabela oraresh. (transporti interurban, Kullë)
21. Nuk ka mbështetje për biznesin e vogël. Bashkia më shumë e sulmon sesa e ndihmon.
22. Nuk ka kanalizime dhe kur bie shi përmytet. Rruga bëhet e pakalueshme. Por dhe në situata të tjera, nuk as trotuare, as vendkalime këmbësorësh. (Katund i Ri)
23. Dalja e lumit Erzen është problematike. është dëmtuar shtrati nga ndërhyrjet e pakontrolluara dhe pa studiuar.

24. Duhet të shtrohen rrugët dytësore. I bëjmë këto rrugë në këmbë që çojmë fëmijët në shkollë, ndonjëherë shkojnë dhe vet. Janë të rrezikuar nga makinat.
25. Shërbimet sociale nuk funksionojnë siç duhet. Nuk dimë ku të drejtohem. Qendrat administrative janë larg. Më së shumti komuniteti ynë ka probleme me fëmijët.
26. Nuk ka qendra apo shërbime për të moshuarit. As ndonjë park apo dy stola ku të ulen nuk kanë.
27. Mosha e tretë është shumë e lënë pas dore.
28. Për komnatat, qendrat e shërbimeve sociale janë larg. Nuk njohim as punojnësit që të dimë ku të drejtohem. Kjo është shprehur si problematikë dhe nga ana e punonjësve.
29. Jo të gjithë kanë akses në teknologji për të marroë informacione dhe njoftime. Grupet e specialistëve duhet të dalin dhe në terren, për të qenë sa më pranë qytetarëve dhe realitetit.
30. Duhet të ketë ura të tjera komunikimi me Bashkinë përveç zyrës së informacionit.
31. Ka mungesë transparence nga Bashkia.
32. Në shkollat e rindërtuara nga tërmeti ka mungesë shkallësh emergjence.
33. Në shkollën 9-vjeçare “Qemal Mici” palestra është jofunksonale, pasi është në katin nëntokë dhe ambjenti nuk ka oksigjen mjaftueshëm.
34. Shkolla e mesme “Neim Babameto” ka mungesë energjie elektrike në disa klasa për shkak të problemeve me qarkun. Në ditë me shi pikon tavani, procesi mësimor bëhet shumë i vështirë.
35. Ka patur ndërrim të shpeshtë të stafit mjekësor, mjekët e familjes dhe kemi vështirësi në ndjekjen e problematikave shëndetësore që mund të kemi. (Nishtulla)
36. Duhet të ketë një qendër rezidenciale ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, në mënyrë që fëmija të kalojë ditën aty dhe gjatë kësaj kohe prindi të ketë mundësi të punësohet.
37. Duke e patur fëmijën me aftësi të kufizuara, ka nevojë për një shoqërues gjatë gjithë kohës, prandaj nuk mundem të punoj. Të paktën këto vite që nuk punojmë sepse kujdesemi për fëmijët, të njihen si vjetërsi pune.
38. Kemi patur vështirësi me përfitimin e banesave sociale, e pretekstin që nuk plotësojmë kushtet. Duhet të rishikohen kriteret, sepse janë absurde.
39. Kur përdorim transportin publik, të paktën për fëmijët të mos paguajmë ose të ketë librezë apo abone specifike. Kemi informacion që për këtë pjesë ka fonde specifike në Bashki, por nuk vendosen në dispozicion.
40. Për fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të ketë programe argëtimi, të kenë si ta kalojnë dhe ata ditën si fëmijë të tjerë. Por nëse nuk ka hapësira dhe staf, nuk kanë si të organizohen.

4. Konkluzione

Nga të gjitha takimet e realizuara dhe analiza e raporteve përkatëse, dalim në përfundimin që prioritetet nuk duket të kenë qenë nën vëmendjen e Bashkisë gjatë dy viteve të kaluara. Kjo për shkak të fokusit në rindërtimin dhe rikonstruksionin e ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019 dhe investime apo shpenzime të tjera që qenë të nevojshme në këtë situatë. Në këtë pikë, kishte mirëkuptim dhe nga ana e qytetarëve, për të cilët ndër të tjera, ky ishte një prioritet përtej atyre në kontratën sociale. Megjithatë, ata mendojnë se investimet në situatën emergjente, nuk duhen përdorur si justifikim për të anashkaluar prioritetet e tjera, të cilat qëndrojnë të paplotësuara apo pjesërisht të plotësuara. Bashkia duhet t'i ketë nën vëmendje në hartimin e buxhetit të vitit të ardhshëm.